REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr.57, datë30.06.2026

"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR MUAJIN MAJ 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9, neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 3, date 29.01.2026 "Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026", me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% (përqind) dhe trajtimin ne total 20 familje me një fond prej 71.918 (shtatëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë dhe konkretisht:
   a. Për Bashkinë Sarandë 20 familje me një fond prej 71.918 (shtatëdhjetë e njëmijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë sipas listës nr.1 bashkëlidhur.
   b. Për Njësinë Administrative Ksamil 0 familje me nje fond 0(zero) lekë
2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

Adresa: Rruga Abedin Dino nr.11, ëeb: ëeb.bashkiasarande.gov.al, Email:info@ bashkiasarande.gov.al

Lista nr.1

Nr.	Emri Atësia Mbiemri	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Agapi Ali Rustemi	Kryefamiljare, grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë.
2	Stavrulla perikli Gaja	Kryefamiljare, grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë.
3	Drita Ruashit Saliaj	Kryefamiljare, grua, me të ardhura të pamjaftueshme dhe me probleme sociale.
4	Kostando Thodhori Llambro	Kryefamiljare, grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme.
5	Mariana Petref Ahmeti	Kryefamiljare, grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë.
6	Marijana Koço Bubuçi	Kryefamiljare, grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë.
7	Leni Filip Dhrami	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
8	Hanko Koçi Kordha	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
9	Faike Hysen Delilaj	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, prag pensioni
10	Pranvera Dervish Daci	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
11	Luljeta Ilmas Jaho	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
12	Polina Ilesh Marku	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
13	Neko Beqir Sheme	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
14	Nimete Habip Çukori	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
15	Nimete Ali Hasani	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, pensionistë
16	Maria Idriz Muço	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, prag pensioni.
17	Violeta Tahir Mehmeti	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, prag pensioni.
18	Marjana Pando Sotiri	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, prag pensioni.
19	Pranvera Bujar Gkergkis	Kryefamiljare grua, skualifikuar për pikë të pamjaftueshme, prag pensioni.
20	Valmira Selam Feruli	Kryefamiljare grua e ve, dy fëmijë.

BASHKIA SARANDE

Drejtoria e Kujdesit Social

LISTA E FAMILJEVE, NDIHME EKONOMIKE PER PERIUDHEN 1-31 maj 2026

Nga fondi 6% i bllokskemës së ndihmës ekonomike

	EMRI ATESIA MBIEMRI I APLIKANTIT	EMRI ATESIA MBIEMRI I PERSONIT QE DO TE TERHEQE NE	Numri I pjestarve	Masa e pageses	SHUMA
	Për Bashkinë qendër Sarandë			0	
1	Agapi Ali Rustemi	Agapi Ali Rustemi	1	3146	3146
2	Stavrulla Perikli Gaja	Stavrulla Perikli Gaja	1	3146	3146
3	Drita Rushit Saliaj	Drita Rushit Saliaj	1	2178	2178
4	Kostando Thodhori Llambro	Kostando Thodhori	1	3146	3146
5	Mariana Petref Ahmeti	Mariana Petref Ahmeti	1	3146	3146
6	Marijana Koço Bubuçi	Marijana Koço Bubuçi	1	3146	3146
7	Leni Filip Dhrami	Leni Filip Dhrami	1	3146	3146
8	Hanko Koçi Kordha	Hanko Koçi Kordha	1	3146	3146
9	Faike Hysen Delilaj	Faike Hysen Delilaj	1	3146	3146
10	Pranvera Dervish Daci	Pranvera Dervish Daci	1	3146	3146
11	Luljeta Ilmas Jaho	Luljeta Ilmas Jaho	1	3146	3146
12	Polina Llesh Marku	Polina Llesh Marku	1	2178	2178
13	Neko Beqir Sheme	Neko Beqir Sheme	1	3146	3146
14	Nimete Habip Çukori	Nimete Habip Çukori	1	5720	5720
15	Nimete Ali Hasani	Nimete Ali Hasani	1	3146	3146
16	Marija Idriz Muço	Marija Idriz Muço	1	3146	3146
17	Violeta Tahir Mehmeti	Violeta Tahir Mehmeti	1	3146	3146
18	Marjana Pando Sotiri	Marjana Pando Sotiri	1	3146	3146
19	Pranvera Bujar Gkergkis	Pranvera Bujar Gkergkis	2	5940	5940
20	Valmira Selam Feruli	Valmira Selam Feruli	3	8712	8712
	shuma		23	**71918**	**71918**

Administrator Shoqeror
Sofia Thano

Pergj per NE
Anila Pikuli

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

PËR PROJEKT VENDIMIN

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR MUAJIN MAJ 2026

Bashkia Sarandë në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6 për qind" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 3 date 29.01.2026" Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026" propozojmë Këshillit Bashkiak relacionin si më poshtë vijon:
Përfitojne ndihmë ekonomike:
Bashkia Sarandë në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 dhe neni 24, ka aprovuar kriteret si me poshte:

a) Familje të cilat kanë aplikuar më parë në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak të pikëve të pamjaftueshme dhe janë familje në nevojë
b) Fëmije jetimë nga nje ose të dy prinderit ose të braktisur.
c) Familje me kryefamiljare femra që janë prag pensioni (56 vjeç ose më shumë)dhe pa të afërm në vendbanim si dhe pensioniste të vetmuara kur masa e pensionit të tyre është e barabartë ose më e vogël se 16000 lekë/muaj.
d) Familje qe kane ne perberje anëtarë ne moshe pune ne kushte te varferise extreme
e) Familje me probleme të thella sociale që nuk mundin të realizojnë proçeset gjyqësore për zgjidhje martese dhe vendimet për UMM.
f) Familje në nevojë që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin.
g) Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me paaftësi/sëmundje të rënda si kur perfitojnë pagesa paaftesie, por edhe në rastet kur nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushte të vështira social-ekonomike;
h) Viktimat e dhunës në mardhëniet familjare edhe 3 muaj pas perfundimit të periudhës së vlefshmërisë se UM, kur nuk kanë të ardhura .
i) Familje te varfera të cilat mund të kenë të ardhura mujore nga punësimi deri në masën 15000 lekë për frymë.
j) Familjet te cilat janë skualifikuar nga sistemi per shkak te mosazhornimit në kohë të tij e provuar me dokumenta si dhe raport social për gjendjen e familjes si familje ne nevoje
k) Familje rome te varfera dhe extremisht te varfera qe kane probleme me dokumentacionin.

l) *Familje te cilat gjenden ne kushte te një fatkeqesie te papritur, per nje periudhe* dymujore, deri sa te plotesojne dokumentacionin perkates dhe te kryhen verifikime te hollesishme (per NE nga te ardhurat e Bashkise)

m) Ne çdo rast dokumentacioni do të shoqërohet me raport social të përgatitur nga punonjësi social ose sipas rastit Njesia e mbrojtjes se fëmijve, Kordinatori kundër dhunës në familje etj. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 597 datë 4.09.2019 "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" , i ndyshuar VKm Nr 855 date 26.12.2024. dhe të gjitha familjet do të trajtohen me ndihmë ekonomike pasi të jetë kryer paraprakisht vlerësimi socio-ekonomik në familje, masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 617 date 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 597 datë 4.09.2019.

Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, familjet që ne perberjen e tyre kanë qoftë edhe nje anetarë të familjes, që plotesojnë kushtet sipas percaktimeve sipas pikes 11) te VKM Nr 597 dt 04.09.2019 te ndryshuar. Per situata specifike ne bazë te raportit social familjes i kerkohen dokumenta shtesë si vërtetim shkolle për anetaret e familjes qe ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, vertetim ushtrie, vertetim nga sistemi TIMS per hyrje dalje jashtë shtetit, vertetim nga institucione shëndetësore etj.

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	20	71918
2	Njesia Administrative Ksamil		

Për muajin maj fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6% është llogaritur mbi shumën 1,219,249 lekë, shumë kjo e miratuar Vendim Nr 5 datë 25/05/ 2026 nga Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Vlorë për 187 përfitues . Fondi i llogaritur është 73155 lekë nga i cili do të përdoren 71918 lekë sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi. Nga Drejtoria e Kujdesit Social u morën në shqyrtim për tu rekomanduar për muajin maj 2026, 20 familje përfituese nga te cilat 20 familje ne Sarande dhe 0 familje ne Njesinë administrative Ksamil. Esmine Jakupi, Evanthia Petko dhe Brunilda Çela, kanë dale nga skema sepse kane kryer aplikim te ri, kurse Maria Muço, Marjana Sotiri dhe Violeta Mehmeti jane rifutur ne skeme si kf gra, pensioniste me te ardhura minimale.

Znj. Sofia Thano
Administrator shoqëror , Drejtoria e Kujdesit Social

Znj.Garufo Koka
Drejtor , Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli

Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr.58 datë30.06.2026

"MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR MUAJIN PRILL 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 3 date 29.01.2026" Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026 "Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbeshtetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin Maj 2026 në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 51 familje me një fond 215.893 (*dyqind e pesëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nentedhjetë e tre)* lekë dhe konkretisht:

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	39	149.563
2	Njesia Administrative Ksamil	12	66.330

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Maj janë sipas listës bashkëlidhur.

Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike familjet si më poshtë:

Qendra e Bashkisë Sarandë

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e daljes nga skema
1	Maria Idriz Muço	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
2	Marjana Pando Sotiri	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
3	Violeta Tahir Mehmeti	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
4	Foto Zaho Lapa	Nuk eshte paraqitur per deklarim

Rifuten ne skemën e ndihmës ekonomike në Bashkinë Sarandë 3 familje:

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Esmine Sulo Jakupi	Kryefamiljare grua pensioniste
2	Evanthia Gjik Petko	Kryefamiljare grua pensioniste
3	Brunilda Zyfer Çela	Kryefamiljare grua me dy fëmijë dhe me probleme sociale

2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION
PËR PROJEKT VENDIMIN
"MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR MUAJIN MAJ 2026"

Bashkia Sarandë në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë " , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" , ", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 3 date 29.01.2026" Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor për vitin 2026 "Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëM ", propozojmë Këshillit Bashkiak relacionin si më poshtë vijon:
Bashkia Sarandë në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24.
Familjet te cilat kanë aplikuar më pare në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak te pikeve te pamjaftueshme dhe jane te varfëra.

a) Familje të cilat kanë aplikuar më parë në sistem dhe nuk kanë përfituar për shkak të pikëve të pamjaftueshme dhe janë familje në nevojë
b) Fëmije jetimë nga nje ose të dy prinderit ose të braktisur.
c) Familje me kryefamiljare femra që janë prag pensioni (56 vjeç ose më shumë)dhe pa të afërm në vendbanim si dhe pensioniste të vetmuara kur masa e pensionit të tyre është e barabartë ose më e vogël se 16000 lekë/muaj.
d) Familje qe kane ne perberje anëtarë ne moshe pune ne kushte te varferise extreme
e) Familje me probleme të thella sociale që nuk mundin të realizojnë proçeset gjyqësore për zgjidhje martese dhe vendimet për UMM.
f) Familje në nevojë që kanë në përbërje fëmijë që ndjekin universitetin.
g) Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtare me paaftësi/sëmundje të rënda si kur perfitojnë pagesa paaftesie, por edhe në rastet kur nuk përfitojnë nga KMCAP-ja dhe janë në kushte të vështira social-ekonomike;
h) Viktimat e dhunës në mardhëniet familjare edhe 3 muaj pas perfundimit të periudhës së vlefshmërisë se UM, kur nuk kanë të ardhura .
i) Familje te varfera të cilat mund të kenë të ardhura mujore nga punësimi deri në masën 15000 lekë për frymë.
j) Familjet te cilat janë skualifikuar nga sistemi per shkak te mosazhornimit në kohë të tij e provuar me dokumenta si dhe raport social për gjendjen e familjes si familje ne nevoje
k) Familje rome te varfera dhe extremisht te varfera qe kane probleme me dokumentacionin.
l) Familje te cilat gjenden ne kushte te një fatkeqesie te papritur, per nje periudhe dymujore, deri sa te plotesojne dokumentacionin perkates dhe te kryhen verifikime te hollesishme (per NE nga te ardhurat e Bashkise)
m) Ne çdo rast dokumentacioni do të shoqërohet me raport social të përgatitur nga punonjësi social ose sipas rastit Njesia e mbrojtjes se fëmijve, Kordinatori kundër dhunës në familje etj.

Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 597 datë 4.09.2019 "Për përcaktimin e proçedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" , i ndyshuar VKm Nr 855 date 26.12.2024. dhe të gjitha familjet do të trajtohen me *ndihmë ekonomike pasi të jetë* kryer paraprakisht vlerësimi socio-ekonomik në familje, masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 617 date 22.09.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 597 datë 4.09.2019,

Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike, familjet që ne perberjen e tyre kanë qoftë edhe nje anetarë të familjes, që plotesojnë kushtet sipas percaktimeve sipas pikes 11) te VKM Nr 597 dt 04.09.2019 te ndryshuar. Per situata specifike ne bazë te raportit social familjes i kerkohen dokumenta shtesë si vërtetim shkolle për anetaret e familjes qe ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, vertetim ushtrie, vertetim nga sistemi TIMS per hyrje dalje jashtë shtetit, vertetim nga institucione shëndetësore etj.

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbeshtetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin maj 2026 në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 51 familje me një fond 215893 (dyqind e pesëmbëdhjetëmijë e tetëqind e nentedhjetë e tre) lekë dhe konkretisht:

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	39	149563
2	Njesia Administrative Ksamil	12	66330

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin maj janë sipas listës bashkëlidhur.

Kanë dalë nga skema 3 familje në Sarandë(Maria Muço, Marjana Sotiri, Violeta Mehmeti) pensioniste të cilat të perfitojnë nga skema 6% e bllokskemës së NE, dhe nje familje (Foto Lapa) i cili nuk ka kryer deklarimin e radhës . Jane rifutur ne skemë 2 familje me kryefamiljare gra pensioniste me te ardhura te pamjaftueshme(Esmine Jakupi, Evanthia Petko) dhe nje kryefamiljare grua me dy femijë me probleme te theksuara sociale (Brunilda Çelo) .

Nuk kemi hyrje dhe dalje në skemë per Njësinë administrative Ksamil për muajin maj 2026

Znj. Sofia Thano
Administrator shoqëror , Drejtoria e Kujdesit Social

Znj. Garufo Koka
Drejtor , Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli
Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social

Bashkia Sarandë
Drejtoria e Kujdesit Social

LISTA E FAMILJEVE QE DO TE PERFITOJNE ND. EKONOMIKE NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER PERIUDHEN 1- 31 05.2026

Nr	Emri Atesia Mbiemri	EMRI ATESIA MBIEMRI I PERSONIT QE DO TE TERHEQE NE	Nr.fryme ve	Masa e ndihmes sipas strukture se	Shuma perfitues e për çdo familje
1	Kristaq Spiro Lezo	Kristaq Spiro Lezo	1	2178	2178
2	Irini Harun Hoxha	Irini Harun Hoxha	1	3146	3146
3	Evdoksia Vangjel Zeneli	Evdoksia Vangjel Zeneli	1	3146	3146
4	Geraldo Dashamir Sheme	Geraldo Dashamir Sheme	1	2178	2178
5	Alida Nasip Metaj	Alida Nasip Metaj	1	2178	2178
6	Qafile Nexhij Azizaj	Qafile Nexhij Azizaj	1	3146	3146
7	Kujtim Qerim Ruçi	Kujtim Qerim Ruçi	1	3146	3146
8	Novruze Myrteza Terolli	Novruze Myrteza Terolli	1	3146	3146
9	Vidë Njac Vata	Vidë Njac Vata	1	2178	2178
10	Muhazeze galip Avdi	Muhazeze galip Avdi	1	3146	3146
11	Elida Hajredin Kanani	Elida Hajredin Kanani	1	3146	3146
12	Mjaftoni Pëllumb Ibraj	Mjaftoni Pëllumb Ibraj	1	3146	3146
13	Vasiliqi Resmi mërtiri	Vasiliqi Resmi mërtiri	1	3146	3146
14	Engjëllushe Abaz Bushi	Engjëllushe Abaz Bushi	1	3146	3146
15	Vito Xhevit Beduli	Vito Xhevit Beduli	1	3146	3146
16	Liri Islam Muçodemi	Liri Islam Muçodemi	1	3146	3146
17	Tanë Flamur Sheme	Tanë Flamur Sheme	1	3146	3146
18	Afërdita Hajdar Allushi	Afërdita Hajdar Allushi	1	3146	3146
19	Sulltana Halim Sulka	Sulltana Halim Sulka	1	3146	3146
20	Jorgjia Nestor Kozllorof	Jorgjia Nestor Kozllorof	1	3146	3146
21	Esmine Sulo Jakupi	Esmine Sulo Jakupi	1	3146	3146
22	Evanthia Gjik Petko	Evanthia Gjik Petko	1	3146	3146
23	Valentina Lilo Skendi	Valentina Lilo Skendi	2	1980	1980
24	Afroviti Rustem Mehmeti	Afroviti Rustem Mehmeti	2	3146	3146
25	Pëllumb Tare Gjonaj	Qerime Gjonaj	2	3703	3703
26	Harallamb Jashar Dervishaj	Izmini Veli Dervishaj	2	3703	3703
27	Spiro Polo Milo	Spiro Polo Milo	2	3703	3703
28	Kadri Beqir Xhafa	Nazife Hair Xhafa	2	3703	3703
29	Anita Alket Tare	Anita Alket Tare	2	5940	5940

30	Kristaq Kujtim Zyma	Kristaq Kujtim Zyma	2	3960	3960
31	Hamdi Demir Çiku	Drita Çiku	2	3703	3703
32	Valbona Tajar Bushi	Valbona Tajar Bushi	2	6240	6240
33	Lindita Novruz Zyliftari	Lindita Novruz Zyliftari	3	3960	3960
34	Resmi Sami Mekshi	Resmi Sami Mekshi	3	4356	4356
35	Brunilda Zyfer çela	Brunilda Zyfer çela	3	7920	7920
36	Xhiola Bilbil Likaj	Xhiola Bilbil Likaj	4	9900	9900
37	Fatmira Ismet Alikaj	Fatmira Ismet Alikaj	4	5891	5891
38	Maria Arben Zenuni	Maria Arben Zenuni	4	5445	5445
39	Daniel Petrit Shaqiri	Xhoana Fatos Shaqiri	5	6970	6970
	Shuma			149563	149563

Administrator Shoqëror
Sofia Thano

Përgj për NE
Anila Pikuli

LISTE PARAQITJE E PERSONAVE QE PERFITOJNE NDIHME EKONOMIKE
NGA TE ARDHURAT E BASHKISE

(Njesia Administrative Ksamil) muaji MAJ 2026

nr	Emer Atesi Mbiemer kryefamiljari	Emer Atesi Mbiemri i bashkeshortes qe terheq leket,	Nr anetarë	Shuma lek
1	Daniel Eduart Haxhiu	Daniel Eduart Haxhiu	3	3267
2	Xhafer Haredin Mançe	Sose Sheme Mançe	2	3703
3	Hava Servet Shehu	Hava Servet Shehu	2	6534
4	Skender Kamber Kamberi	Skender Kamber Kamberi	3	4356
5	Marsela Vait Buzaj	Marsela Vait Buzaj	6..	14652
6	Albert Bardhul Daka	Albert Bardhul Daka	1..	2178
7	Alma Kujtim Kadiu	Alma Kujtim Kadiu	3..	6732
8	Kristi Fatos Manolaj	Kristi Fatos Manolaj	2..	3267
9	Lulezim Haxhi Hajdari	Lulezim Haxhi Hajdari	4..	3049
10	Tajar Jonuz Sela	Vjollca Sihat Sela	4...	5881
11	Dafina Ali Pana	Dafina Ali Pana	3..	7920
12	Ilir Enver Kreci	Albana Kreci	3..	4791
	SHUMA			66330

ADMINISTRATORE
Ardiana ABEDINI

ADM.SHOQER
Fatbardha LAM

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ADMINISTRATIVE BASHKIA SARANDË KSAMIL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.59, datë30.06.2026

"PËR MIRATIMIN E SHTETASIT K.Z PËR T'U TRAJTUAR NË QENDRËN POLIVALENTE DITORE TË TË MOSHUARVE "FETI RUGJI" SARANDË"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë ", Ligjin nr.121/2016 ''Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë'' neni 28, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.518 date 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.73 datë 23.12.2024 "Për miratimin e detajimit të buxheTit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Sarandë "dhe relacionin e Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Rasteve në Nevojë, me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të trajtohet në Qendrën Polivalente Ditore të të moshuarve "Feti Rugji", të moshuarit e vetmuar Z. Kostandin Zoto, në moshë pensioni, me vështirësi ekonomiko-sociale dhe i aftë për jetë kolektive.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Qendra Polivante e të Moshuarve "Feti Rugji".
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION

PËR PROJEKT VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E SHTETASIT K.Z PËR T'U TRAJTUAR NË QENDRËN POLIVALENTE DITORE TË TË MOSHUARVE "FETI RUGJI" SARANDË"

Të ndëruar Këshilltarë!

Bashkia Sarandë në mbështetje të legjislacionit në fuqi për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, paraqet përpara jush projekt vendimin "*Për miratimin e shtetasit K.Z për tu trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë*", me arsyetimin si më poshtë:

Në Drejtorinë e Kujdesit Social në muajin shkurt të vitit 2026, është paraqitur një kërkesë për përfitimin e shërbimit ditor pranë Qendrës Polivalente Për të Moshuarit "Feti Rugji". Komisioni Multidisiplinar i Vlerësimit të Rasteve në Nevojë shqyrtoi kërkesën e të moshuarit dhe vendosi që të marri shërbimin ditor i moshuari me probleme social ekonomike.

- Kostandin Jorgo Zoto

Konstandin Zoto eshte një i moshuar i vetmuar pasi bashkeshortja e tij ka nderruar jete dhe femijet i ka ne emigracion. Te ardhurat e tij jane minimale pasi trajtohet me nje pension pleqërie urban ne masën 10.752 leke, i cili eshte i pamjaftueshem per t'u ushqyer dhe per te marre medikamentet qe i nevojiten. Ndodhur ne keto kushte i drejtohet Bashkisë Sarandë për t'u ndihmuar me ushqim ne qendren Polivalente ditore te te moshuarve Sarande. Gjithashtu te jete dhe ne shoqërine e bashkemoshatarëve te vet për të zbutur sadopak vetmine që e rrethon.

Ndodhur në këto kushte dhe ne zbatim te ligjit 121/2016 "Per shërbimet e kujdesit shoqeror", si dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018, komisjoni Multidisiplinar i Vleresimit dhe Referimit te Rasteve ne Nevoje krijuar me urdher te Kryetarit te Bashkise nr 284 date 06.11.2023 vendosi që i moshuari Kostandin Zoto të marri sherbimin ditor prane Qendres Ditore Polivalente "Feti Rugji" Sarandë.

Nisur nga arsyet e mësipërme dhe pamundësi që t'i shërbejnë vetes, propozojmë të trajtohet tek Qendra e të Moshuarve për të qënë të integruar në shoqeri dhe për të përmiresuar sadopak cilësinë e jetesës së tij.

Për sa arsyetuam më lartë, shpresojmë në votimin e projekt vendimit *"Për miratimin e shtetasit K.Z për tu trajtuar në qendrën polivalente ditore të të moshuarve "Feti Rugji" Sarandë"*.

Znj. Emanuela Çetri
Përgjegjës, Drejtoria e Kujdesit Social

Znj. Garufo Koka
Drejtore, Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli
Drejtore, Drejtoria e Kujdesit Social

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 60 datë 30.06 2026

" PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 FAZA I"

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015"per veteqeverisjen Vendore", neni 9 pika c dhe ç, neni 54 germa ç dhe dh, Ligji 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr.68 date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjit 9632 date 30.10.2006, "Per sistemin e taksave vendore", Ligji 9975 date 2.07.2008,"Per taksat kombetare" i ndryshuar, UMF nr.7, date 25.02.2022" Per nje ndryshim ne Udhezimin nr.23, date 30.07.2018"Per procedurat standarte te pregatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem te njesive te veteqeverisjes vendore", Udhëzimin nr 7 datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027-2029", Këshilli Bashkiak pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga strukturat e Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Miratimin e të ardhurave Vendore Afatmesme 2027-2029, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur pjese e ketij vendimi.
2. Miratimin e shpenzimeve publike të programit afatmesëm 2027-2029, në nivel programi, sipas tabelës nr.2 bashkëlidhur, pjesë e këtij vendimi.
3. Miratimin e shpenzimeve për programin e investimeve publike 2027-2029, sipas tabelës nr.3, pjes e ketij vendimi.
4. Miratimin e numrit të punonjësve të administratës për periudhën 2027-2029, sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë e këtij vendimi.
5. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës, Drejtoria e Sherbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si dhe institucionet në varësi të Bashkisë Sarande, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar .

KRYETAR
Ollton ÇAÇI

Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

BASHKIA SARANDE

PROJEKT DOKUMENTI I

PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM
2027 - 2029

Sarande, Qershor 2026

SHPENZIMET NË NIVEL PROGRAMI, DHE NIVELI I TE ARDHURAVE TE PBA 2027-2029 (FAZA E PARE)

Procesi i hartimit te Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për, "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor, Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" te Udhezimit nr 7 date 27.02.2026, Per pregatitjen e PBA 2027-2029, u parashikua nivelin i të ardhurave dhe tavanet e shpenzimeve publike, në nivel programi, për periudhën afatmesme 2026-2028.

Keshilli Bashkiak me Vendim Nr.151. date 23.12.2025 "Per miratimin e buxhetit afat mesem 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit te vitit 2026" ka miratuar edhe kalendarin e pergatitjes se PBA 2027-2029.

Formatet e perdorura per miratimin e PBA jane konform kerkesave ligjore per planifikimin buxhetor, duke perfshire elementet e nevojshem si pema e programeve, qellimet ,objektivat pema e produkteve, klasifikimi ekonomik, etj., pjese e Sistemit te Menaxhimit Buxhetor Vendor (SMBV) si nje aplikacion i mbeshtetur ne baze te dhenash, i cili do te lehtesoje dhe do te siguroje gjithperfshirjen e te gjitha paleve pergjegjese ne pergatitjen e PBA 2026-2028 nga formatet elektronike prej te cilit varet edhe hartimi teknik i PBA.

Udhezimi standart i hartimit PBA perfshin;

a) Rolet dhe pergjegjesite per Kryetarin e NJQV-se ,Keshillin e NJQV-se, GMS, Drejtuesir dhe anetareve te EMP-ve si edhe MF-se,.
b) Procedurat,fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjine per programin dhe buxhetimin.
c) Kerkesat e raportimit te PBA; Misionin e Njesise te vetqeverisjes vendore dhe trukturen e programeve; Deklaraten e politikes se programeve, Tavanet e NjVQV; Shpenzimet e progameve;Shpenzimet e programeve sipas produkteve;; Projektet me financim te brendshem.

Udhezimi vjetor i PBA -se, percakton kerkesat specifike per procesin e PBA-se te NJQV , duke perfshire edhe kerkesa te vecanta per hartimin e praogramit buxhetor afatmesem.

a) Afatet per pergatitjen e dokumentit te PBA-se dhe Informacionin mbi transferten e pakushtezuarte pergjithshme dhe ate sektoriale per periudhen afatmesme.
b) Procesin e pergatitjes se PBA, Hartimi i tavaneve Buxhetore te PBA -se ; Organizimit te procesit; Pemes se programeve, Draft dokumentin e PBA -se
c) Dokumenti i PBA -se eshte pergatitut nepermjet Sistemit te Menaxhimit Te Buxhetit Vendor (SMBV). Nga MFE eshte vene ne dispozicion nje llogari perdoruesi per sekretarin e GMS -

Se (Nepunesi Zbatues), dhe nepermjet tij krijohen llogarite e anetareve te tjere te stafit te Bashkise bazuar ne rolet e tyre ne hartimin e Buxhetit vjetor.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

1. Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent thelbesor i planifikimit buxhetor ne nilev kombëtar dhe vendor.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin **mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej** dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare.

Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë **për planifikimin e investimeve publike** sipas programeve buxhetore duke përfshirë **edhe kërkesat për shpenzimet korente**. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në parashikimin e treguesave të rëndësishëm të Programit Buxhetor AM 2026-2028, Grupi i menaxhimit Strategjik u mbështet në infrastrukturën ligjore e n/ligjore përkatëse të MFE në metodologjinë e planifikimit prognozë si dhe në ecurinë e realizimin faktik gjatë periudhës 2023-2025. Përcaktimi i nivelit të të ardhurave sipas zërave e burimeve të krijimit si dhe i **tavaneve limit të shpenzimeve publike në nivel programi**, përbëjnë domosdoshmëri për një zhvillim të qëndrueshëm afat-mesëm vendor.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Ne Programin Buxhetor Afatmesem(PBA) perfshihen:

a. Aparati i Bashkise Sarande
b. Njesite e Varesise

PBA-ja eshte hartuar ne baze te funksioneve, ku cdo funksion ledhet me disa programe te pushtetit vendor, brenda te cilave jane perfshire nje ose me shume Njesi Shpenzuese, ne perputhje me funksionet dhe qellimet perkatese per cdo njesi.

Per cdo program jane parashikuar te gjitha shpenzimet qe do te sherbejne per realizimin e objektivave te tij, sipas lloit dhe Njesive Shpenzuese.

Shpenzimet e buxhetit te Bashkise Sarande sipas natyres jane:

a. Shpenzime personeli
b. Shpenzime operative
c. Shpenzime kapitale
d. Fondi Rezerve dhe kontigjences

2. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029

Objektivi i politikave afat mesme te Bashkise Sarande eshte zhvillimi i qëndrueshëm, qe e pare nga këndvështrimi i këtij dokumenti është projektuar si një qasje e sistemit aktual vendor drejt rritjes dhe zhvillimit urban dhe rural, duke siguruar një manaxhim të suksesshëm të kapitalit natyror, njerëzor dhe social për rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe gjeneratave të ardhshme.

Vizioni ynë për tre vitet e ardhshme projekton Saranden si një qytet te aksesueshëm falë përmirësimit të infrastrukturës publike; një qytet që zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur ekuilibrat mes zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit social, mbrojtjes së mjedisit; një qytet gjithëpërfshirës që ka si prioritet ndërtimin e një mjedisi të sigurt për zhvillimin e pjesëmarrjen e të rinjve dhe që garanton mbrojtje dhe përkujdesje për grupet në nevojë.

Objektivat per projekte madhore ne 3 vejcarin e ardhshem;

- **Ndertimi i rruges se gjashte**, aktualisht ne perfundim te fazes se projektimit eshte nje projekt madhor ,duke i dhene nje dimension tjeter aksesit ne Sarande, per te lehtesuar levizshmerine, dhe zhvillimin e sigurt ekonomik te qytetit dhe jo vetem. Ky projekt synon te lehtesoje levizjen ne hyrje dhe dale te Sarandes kryesisht ne sezonin veror, duke u bere nje porte tjeter dytesore ne veri – perendim. Ne projekt perfshihet edhe nje tunel qe do te lidhe rrugen e bregdetit jugor me Saranden , ne menyren per panoramike te mundshme ne funksion te turizmit dhe ekonomise vendore.
- **Ndertimi i shetitores ne Ksamil**, eshte nje projekt tjeter madhor ne 3 vitet e ardhshme , ne funksion te turizmit dhe ekonomise te qendrueshme te asaj zone dhe jo vetem. Shetitorja do te jete e aksesueshme nga qytetaret pergjate vijes bregdetare dhe do jete nje vlere e shtuar per turizmin. Nje projekt i tille eshte shume i vlefshem per nje vend i shumefrekuentuar nga turistet. Njekohesisht do te sherbeje edhe si nje zone relaksimi per vizitoret.
- **Ndertimi nje qendre mikpritje ne Ksamil** me Terrene sportive, sherbimi dhe argetimi, do jete nje tjeter projekt me impakt te ndjeshem ne zonen turistike te Ksamilit. Mungesa e terreneve sportive e ben shume te nevojshme nje projekt te ri bashkohor ne funksion te rinise qe frekuenton Ksamilin si zone turistike.
- **Rikualifikim te Ures se Metoqit,** eshte nje projekt tjeter shume i domosdoshem per ate zone e cila do jete ne funksion te fermereve dhe zhvillimit te Bujqesise.
4520	Rrjeti rrugor Rural	Riveshje shtresa asfaltike ne territorin e Bashkise	11,000	7,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Shkallare lidhese lagj nr 3 dhe rikualifikim shkallare prane Portit	12,000	10,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Rikualifikim I rruges Rilindja Sarande	40,000	30,000		
4520	Rrjeti rrugor Rural	Investime ne infrastrukturen rrugore	151,020	182,521	379,130	395,665
	Total 4520		**552,319**	**386,082**	**379,130**	**395,665**
6260	Sherbime publike Vendore	Investime me fonde te brendshme	27,260	27,260	27,260	27,260
	Total 6260		**27,260**	**27,260**	**27,260**	**27,260**
6370	Furnizimi me ujë,KUZ.	Furniz.me ujë zona periferike L.Dardhë&B.Rexhepi				
6370	Furnizimi me ujë,KUZ.	Investime me fonde te brendshme	11,780	11,780	11,780	11,780
	Total 6370		**11,780**	**11,780**	**11,780**	**11,780**
8130	Programe Kulturore	Investime me fonde te brendshme	6,000	-	130,000	130,000
8130	Programe Kulturore	Rikonstruksioni I Kinoteatrit	30,090	270,000		
	Total 8130		**36,090**	**270,000**	**130,000**	**130,000**
9120	Arsimi Parauniversitar	Investime ne terrene sportive ne shkolla	10,000	20,090	52,000	
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion kopeshti 2 dhe 3	20,080	41,170		
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion Shkollat 9 vjecare Cuke	10,000	18,916		
9120	Arsimi Parauniversitar	Rikonstruksion Kopeshte dhe Shkolla ne Metoq, Shelegar, Berdenesh	10,080	21,604		
	Total 9120		**50,160**	**52,000**	**52,000**	**52,000**
	TOTALI	**Te ardhurat e veta**	**730,869**	**785,766**	**859,908**	**894,982**
			-	-	-	-

DREJTOR FINANCE

Teuta STROKA

DREJTOR I PROJEKTEVE

Martion ZHUPA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.61, datë 30.06.2026

"PËR MIRATIMIN E VENDNDODHJES SË TERMINALIT TË TRANSPORTIT PUBLIK PËR BASHKINË SARANDË, RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE TARIFAVE TË OPERIMIT"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 9, neni 24 , Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, Udhëzimit nr.446, datë 10.05.2018 "Për, kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve", me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendndodhjen e terminalit të transportit publik për Bashkinë Sarandë me adresë, lagjia nr.1, Rruga "Skënderbeu", Sarandë, sipas planvendosjes nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Të miratojë rregulloren e funksionimit sipas aneksit I bashkëlidhur dhe pjesë përbërese të të këtij vendimi.
3. Të miratojë tarifat e operimit të terminalit të transportit publik për Bashkinë Sarandë sipas aneksit II bashkëlidhur dhe pjesë përbërese të të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ndërrmarja e Shërbimeve publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

RELACION PËR PROJEKT VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E VENDNDODHJES SË TERMINALIT TË TRANSPORTIT PUBLIK PËR BASHKINË SARANDË, RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT DHE TARIFAVE TË OPERIMIT"

Të nderuar anëtar të Këshillit Bashkiak!

Projekt-vendimi që paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Sarandë ka për objekt miratimin e vendndodhjes së terminalit të transportit publik të pasagjerëve, rregullores së funksionimit dhe tarifave përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve.

Krijimi dhe funksionimi i terminaleve të transportit publik përbën një detyrim ligjor të njësive të vetëqeverisjes vendore, i parashikuar nga Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, si dhe nga Udhëzimi nr. 446, datë 10.05.2018 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë "*Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, procedurat e autorizimit, mënyrën e administrimit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit*".

Sipas kuadrit ligjor të sipërcituar, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kompetencën për të përcaktuar dhe miratuar vendndodhjen e terminaleve të transportit publik, për të garantuar funksionimin e tyre sipas standardeve ligjore dhe për të mbrojtur interesin publik, sigurinë rrugore dhe mbarëvajtjen e qarkullimit urban.

Aktualisht, Bashkia Sarandë përballet me një fluks të konsiderueshëm të mjeteve të transportit publik ndërurban dhe ndërkombëtar, veçanërisht gjatë sezonit turistik, periudhë gjatë së cilës qyteti regjistron një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve dhe përdoruesve të shërbimeve të transportit. Mungesa e një terminali të organizuar sipas standardeve ligjore sjell vështirësi në menaxhimin e trafikut, krijon pengesa në qarkullimin urban, cenon sigurinë e pasagjerëve dhe vështirëson ofrimin e një shërbimi të rregullt dhe cilësor.

Funksionimi i një terminali të dedikuar do të mundësojë , organizimin dhe disiplinimin e lëvizjes së mjeteve të transportit publik, rritjen e sigurisë së pasagjerëve dhe operatorëve, përmirësimin e menaxhimit të trafikut urban, eliminimin e ndalesave të pakontrolluara në rrugët e qytetit, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për shërbimet ndërurbane dhe ndërkombëtare të transportit.

Rregullorja e propozuar përcakton qartë të drejtat dhe detyrimet e operatorëve, administrimit të terminalit dhe përdoruesve të tij, duke garantuar funksionim transparent, të rregullt dhe në përputhje me interesin publik.

Tarifat e propozuara janë analizuar mbi bazën e kostove të administrimit dhe mirëmbajtjes së terminalit, praktikave të ndjekura në bashki të tjera të vendit dhe parimit të proporcionalitetit, duke

synuar garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimit pa krijuar barrë të pajustifikuar financiare për operatorët e transportit.

Në përfundim, administrata e Bashkisë Sarandë vlerëson se miratimi i këtij projekt-vendimi përmbush një nevojë publike të rëndësishme, është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës së transportit publik, sigurisë rrugore dhe cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve dhe vizitorëve të Bashkisë Sarandë.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i projekt-vendimit *"Për miratimin e vendndodhjes së terminalit të transportit publik për bashkinë sarandë, rregullores së funksionimit dhe tarifave të operimit"*.

Z. Pariken Imeraj

Specialist Jurist, Drejtoria Juridike

Znj. Jonadea Bërxhaj

Specialist transporti , Drejtoria e Shërbimeve Publike

Znj.Garufo Koka

Drejtor, Drejtoria Juridike

Z.Jolio Dine

Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike

RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË TERMINALIT PUBLIK TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE TË BASHKISË SARANDË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton organizimin, administrimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin e Terminalit Publik të Transportit të Udhëtarëve të Bashkisë Sarandë, si dhe të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e administratorit të terminalit, operatorëve të transportit, drejtuesve të mjeteve, pasagjerëve, dhe çdo personi tjetër që përdor ose ushtron aktivitet në territorin e terminalit.

Terminali publik është një infrastrukturë publike e destinuar për organizimin e shërbimit të transportit të udhëtarëve dhe përbën një aset publik në shërbim të interesit të përgjithshëm, zhvillimit ekonomik lokal, përmirësimit të lëvizshmërisë urbane dhe turistike dhe garantimit të standardeve të sigurisë dhe cilësisë së shërbimit.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim:

a) organizimin e funksionimit të terminalit sipas standardeve bashkëkohore të transportit publik;
b) garantimin e sigurisë së udhëtarëve, operatorëve dhe personelit;
c) disiplinimin e qarkullimit të mjeteve të transportit publik në territorin e Bashkisë Sarandë;
d) eliminimin e ndalesave dhe stacioneve të paautorizuara;
e) krijimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të transportit publik;
f) përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe turistëve;
g) administrimin e qëndrueshëm dhe transparent të infrastrukturës publike.

Neni 3
Baza Ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

* Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar
* Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për Transportet Rrugore", i ndryshuar;
*Ligji nr.8378 datë 22.07.1998 " Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
* Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",i ndryshuar
* Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor",i ndryshuar
* Aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria përgjegjëse për transportin;
* Vendimet e Këshillit Bashkiak Sarandë.

Neni 4
Fusha e Veprimit

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike Sarandë, operatorët e transportit publik ndërqytetas ,rreth qytetës , operatorët e transportit turistik, operatorët e transportit ndërkombëtar, subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda terminalit, pasagjerët, operatorët e bashkive që operojnë me një më stacio fundor qytetit e Sarandës dhe çdo përdorues të territorit të terminalit.

Neni 5
Përkufizime

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "*Terminal*" është infrastruktura publike e dedikuar për organizimin e mbërritjeve, nisjeve dhe qëndrimit të përkohshëm të mjeteve të transportit publik.

2. "*Administrator*" është njësia organizative përgjegjëse për funksionimin e një terminali të caktuar.

3. "*Operator transporti*" është person fizik ose juridik i pajisur me licencë për transport udhëtarësh sipas legjislacionit në fuqi.

4. "*Platforme*" është hapësira e përcaktuar për hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve.

KREU II

ADMINISTRIMI I TERMINALIT

Neni 6

Terminali Publik i Transportit të Udhëtarëve është pronë publike e Bashkisë Sarandë dhe administrohet nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë rregullore.

Terminali funksionon si strukturë publike me karakter shërbimi dhe jo diskriminues ndaj operatorëve të licencuar.

Neni 7
Organi Administrues

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë është përgjegjëse për:
a. administrimin e terminalit;
b. organizimin e veprimtarisë operative;
c. mirëmbajtjen e infrastrukturës;
d. mbledhjen e tarifave;

e. menaxhimin e marrëdhënieve me operatorët;
f. garantimin e sigurisë dhe rendit të brendshëm.

Neni 8
Marrëdhëniet me Bashkinë Sarandë

Ndërmarrja raporton periodikisht pranë Bashkisë Sarandë lidhur me:
a. aktivitetin operacional;
b. të ardhurat dhe shpenzimet;
c. investimet dhe mirëmbajtjen;
d. problematikat e konstatuara;
e. masat për përmirësimin e shërbimit.

Bashkia Sarandë ushtron mbikëqyrjen institucionale mbi administrimin e terminalit.

Neni 9
Parimet e Administrimit

Administrimi i terminalit bazohet në parimin e ligjshmërisë, transparencës, efikasitet ekonomik, siguri publike, trajtim të barabartë të operatorëve dhe mbrojtje të interesit publik.

KREU III

KOMPETENCAT E STRUKTURËS ADMINISTRUESE

Neni 10
Kompetencat e Strukturës administruese

Struktura administruese ka detyrë për organizimin dhe kontrollin:

a. Organizon dhe kontrollon hyrjen dhe daljen e mjeteve të transportit në terminal, duke siguruar respektimin e rregullave të qarkullimit, sigurisë dhe orareve të miratuara.

b. Administron dhe cakton platformat sipas linjave dhe operatorëve, duke garantuar përdorim efikas të hapësirave dhe shmangien e konflikteve operacionale.

c. Mbikëqyr respektimin e orareve të mbërritjes dhe nisjes së mjeteve, duke evidentuar dhe raportuar çdo devijim apo vonesë.

d. Siguron informimin, orientimin dhe asistencën e pasagjerëve për të garantuar një shërbim cilësor dhe të aksesueshëm.

e. Mban, përditëson dhe arkivon dokumentacionin administrativ, teknik dhe financiar që lidhet me funksionimin e terminalit.

f. Ndërmerr masat administrative dhe disiplinore ndaj operatorëve ose përdoruesve që shkelin rregullat e funksionimit të terminalit.

g. Kryen administrimin dhe arkëtimin e tarifave të miratuara për përdorimin e terminalit, në përputhje me aktet ligjore dhe financiare në fuqi.

h. Përgatit dhe zbaton planin vjetor të mirëmbajtjes së infrastrukturës, pajisjeve dhe ambienteve të terminalit.

i. Analizon nevojat e terminalit dhe i propozon Bashkisë Sarandë masa për rishikimin e tarifave, përmirësimin e shërbimeve dhe realizimin e investimeve të nevojshme

Neni 13
Detyrimet e Strukturës administruese

Funksionimin e pandërprerë të terminalit, duke organizuar dhe mbikëqyrur të gjitha proceset operacionale, me qëllim ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe efikase për operatorët dhe udhëtarët.

a. Pastërtinë dhe higjenën, duke siguruar mirëmbajtjen e përditshme të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të terminalit, në përputhje me standardet higjieno-sanitare në fuqi.
b. Ndriçimin duke garantuar funksionimin e plotë të sistemit të ndriçimit në të gjitha hapësirat e terminalit, për të siguruar orientimin dhe komoditetin e përdoruesve.
c. Sigurinë duke marrë masa të vazhdueshme për mbrojtjen e pasagjerëve, personelit, mjeteve dhe infrastrukturës së terminalit, përmes sistemeve të monitorimit dhe kontrollit.
d. Aksesin për personat me aftësi të kufizuara duke siguruar kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme që garanton lëvizjen dhe përdorimin e shërbimeve të terminalit në mënyrë të barabartë për të gjithë.
e. Mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike duke kryer kontrollin periodik, përditësimin dhe riparimin e pajisjeve elektronike dhe sistemeve informatike që mbështesin funksionimin e terminalit.

KREU IV

ORGANIZIMI I TERMINALIT DHE PLATFORMAVE

Neni 14
Organizimi Funksional

Terminali organizohet në:

a. Zonën e hyrjes: Përfshin pikat e aksesit për pasagjerët dhe mjetet, ku sigurohet pritja, orientimi dhe kalimi i parë drejt shërbimeve të terminalit.
b. Zonën e kontrollit: Përfshin pikat e verifikimit të dokumentacionit, biletave dhe sigurisë, ku zbatohen procedurat për kontrollin e hyrjes dhe monitorimin e lëvizjes.
c. Platformat e nisjes: Janë platformat ku pasagjerët presin mjetet për nisje dhe nga ku realizohet hyrja e organizuar në mjetet e transportit sipas destinacionit.
d. Platformat e mbërritjes: Janë platformat ku pasagjerët zbresin nga mjetet e transportit dhe orientohen drejt daljeve, shërbimeve ndihmëse ose zonave të pritjes.
e. Zonën e pritjes së pasagjerëve: Është hapësira e akomodimit të pasagjerëve përpara nisjes, e pajisur me ulëse, informacione dhe shërbime bazë për udhëtarët.

f. Zonën e shërbimeve tregtare: Përfshin ambientet ku ofrohen shërbime dhe produkte tregtare si kioska, bare, dyqane dhe shërbime të tjera të përditshme për pasagjerët.
g. Zonat administrative: Përfshin ambientet e zyrave dhe shërbimeve të brendshme që mbështesin menaxhimin, koordinimin dhe funksionimin e terminalit.

Neni 15
Platforma

Platforma klasifikohen sipas kategorive të transportit:

a. transport ndërqytetës: Platforma ku realizohen nisjet dhe mbërritjet e linjave në distanca të mesme dhe të gjata midis qyteteve.
b. transport ndërkombëtar: Platforma e dedikuar për linjat që lidhin vendin me qytete ose shtete të tjera.
c. transport turistik: Platforma e përdorur për linjat dhe udhëtimet turistike, përfshirë autobusët dhe mjetet e dedikuara për vizitorët.
d. transport sezonal: Platforma që përdoren gjatë periudhave të larta të lëvizjes, kur rritet fluksi i pasagjerëve.
e. transport rezervë: Platforma që mbahen në dispozicion për raste të veçanta, devijime ose emergjenca.

Neni 16
Përdorimi i platformeëve

Përdorimi i platformeëve të terminalit kryhet vetëm në përputhje me planin e shpërndarjes dhe organizimit të miratuar nga administrata e terminalit e cila duhet të jetë e publikuar pranë ambjenteve të terminalit , me qëllim garantimin e rendit, sigurisë dhe funksionimit normal të aktivitetit transportues. Çdo operator transporti është i detyruar të respektojë platformein e caktuar dhe oraret përkatëse të shfrytëzimit të tij.

Asnjë operator transporti, drejtues mjeti apo subjekt tjetër nuk lejohet të ndryshojë, zërë ose përdorë një platforme të ndryshëm nga ai i përcaktuar pa autorizim paraprak me shkrim nga administrata e terminalit. Çdo kërkesë për ndryshim të përkohshëm ose të përhershëm të platformeit shqyrtohet nga administrata në bazë të nevojave operative dhe kapaciteteve të terminalit.

Administrata rezervon të drejtën të riorganizojë shpërndarjen e platformeëve në raste të veçanta, si fluks i lartë udhëtarësh, punime mirëmbajtjeje, situata emergjente ose ndryshime në shërbimet e transportit, duke njoftuar operatorët përkatës në kohë të arsyeshme.

Neni 17
Grafiku Operacional

Administrata e terminalit harton, miraton, përditëson dhe publikon grafikun operacional të hyrjeve, nisjeve dhe mbërritjeve të mjeteve të transportit publik, në përputhje me licencat, itineraret dhe

oraret e miratuara nga autoritetet kompetente. Grafiku operacional synon koordinimin efikas të lëvizjes së mjeteve dhe shmangien e mbivendosjeve apo vonesave në funksionimin e terminalit.

Të gjithë operatorët e transportit janë të detyruar të respektojnë oraret e përcaktuara në grafik dhe të informojnë administratën për çdo ndryshim, vonesë ose anulim të shërbimit, në mënyrë që informacioni të përditësohet në kohë reale dhe të garantohet informimi korrekt i udhëtarëve.

Grafiku operacional afishohet në vende të dukshme brenda terminalit, në panelet informuese dhe në sistemin elektronik të informacionit, duke siguruar akses të plotë për udhëtarët, operatorët dhe personelin e terminalit. Administrata merr masat e nevojshme për përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave dhe funksionimin e pandërprerë të sistemit të informimit.

KREU V

PROCEDURAT E HYRJES DHE DALJES SË MJETEVE

Neni 18
Regjistrimi Elektronik

Çdo mjet regjistrohet në databaze e krijuar në formë elektronike ose shkresore përpara hyrjes në terminal, nga struktura administruese. Regjistri përmban:

1. targën: numrin e regjistrimit të mjetit që identifikon në mënyrë unike mjetin në sistem;
2. operatorin: emrin e personit fizik ose juridik përgjegjës për mjetin dhe shërbimin e transportit që kryen;
3. itinerarin: vendin e origjinës, destinacionin dhe rrugën e planifikuar të lëvizjes së mjetit;
4. orarin: datën dhe orën e planifikuar të hyrjes në terminal, si dhe datën dhe orën e planifikuar të daljes;
5. numrin e licencës: numrin e licencës ose autorizimit të vlefshëm për ushtrimin e aktivitetit të transportit;
6. kohën e hyrjes dhe daljes: orën dhe datën reale të hyrjes në terminal dhe të largimit nga ai.

Të dhënat e mësipërme regjistrohen dhe përditësohen në kohë reale në, me qëllim garantimin e gjurmueshmërisë së veprimtarisë së transportit, rritjen e transparencës administrative dhe sigurimin e kontrollit të plotë mbi lëvizjen e mjeteve brenda territorit të terminalit.

Neni 19

Kushtet e Hyrjes

Hyrja në terminal lejohet vetëm për mjetet që disponojnë:

1. licencë të vlefshme për ushtrimin e aktivitetit të transportit dhe çertifikatat shoqëruese te mjeteve që operojnë në rastet përkatëse.

2. autorizim/lejen për linjën përkatëse ose dokumentacion tjetër të kërkuar nga autoritetet kompetente.

Mjetet që nuk plotësojnë një ose më shumë nga kushtet e sipërpërmendura nuk lejohen të hyjnë në terminal deri në plotësimin e kërkesave ligjore. Verifikimi i dokumentacionit kryhet nga personeli i autorizuar i administratës së terminalit përpara lejimit të hyrjes në zonën operacionale.

Neni 20
Kontrolli në Hyrje

Administrata e terminalit ka të drejtë dhe detyrim të verifikojë dokumentacionin e mjeteve dhe të operatorëve të transportit, si dhe të ndalojë hyrjen e mjeteve që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe kjo rregullore.

Kontrolli përfshin verifikimin e dokumenteve origjinale ose elektronike të regjistruara në sistem, kontrollin fizik të mjetit, gjendjen teknike të dukshme të tij, si dhe përputhshmërinë e shërbimit të transportit me autorizimet dhe licencat përkatëse.

Në rast të konstatimit të mangësive, dokumentacionit të pavlefshëm ose shkeljeve të tjera, administrata refuzon hyrjen e mjetit në terminal dhe njofton operatorin për arsyet e refuzimit, duke mbajtur procesverbal ose evidencë elektronike për rastin.

Neni 21
Procedura e Daljes

Dalja e mjeteve nga terminali kryhet sipas grafikut të miratuar të qarkullimit dhe regjistrohet automatikisht në sistemin elektronik të menaxhimit të terminalit.

Çdo devijim nga oraret e miratuara raportohet dhe evidentohet nga administrata, duke specifikuar arsyet e vonesës ose ndryshimit të planifikuar. Operatori i transportit është i detyruar të informojë administratën për çdo ndryshim të orarit të daljes brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja e brendshme e terminalit.

Administrata ka të drejtë të marrë masa organizative për të garantuar mbarëvajtjen e trafikut brenda terminalit dhe respektimin e orareve të miratuara nga operatorët e transportit.

Neni 22
Qëndrimi në Terminal

Mjetet lejohen të qëndrojnë në terminal vetëm për kohën e nevojshme për:

a. ngarkimin dhe shkarkimin e bagazheve ose mallrave;
b. kryerjen e formaliteteve administrative dhe procedurave të kontrollit;
c. pritjen e orarit të nisjes sipas grafikut të miratuar;
d. hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve në mënyrë të sigurt dhe të organizuar.

Qëndrimi i pajustifikuar ose tejkalimi i afateve të lejuara për qëndrim konsiderohet shkelje e kësaj rregulloreje dhe mund të sjellë masa administrative ndaj operatorit ose drejtuesit të mjetit.

Administrata e terminalit ka të drejtë të përcaktojë tarifa shtesë për qëndrimin e zgjatur të mjeteve, sipas tarifave të miratuara dhe rregulloreve në fuqi, si dhe të kërkojë lirimin e menjëhershëm të hapësirave operative kur kjo është e nevojshme për funksionimin normal të terminalit.

KREU VI

MARRËDHËNIET ME OPERATORËT E TRANSPORTIT

Neni 23
Parimet e Bashkëpunimit

Terminali Publik i Transportit të Udhëtarëve funksionon mbi bazën e parimit të aksesit të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët e licencuar të transportit rrugor të udhëtarëve.

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë siguron që përdorimi i terminalit të realizohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe në përputhje me legjislacionin për transportin rrugor, pa favorizuar apo diskriminuar asnjë operator.

Neni 24
Regjistrimi i Operatorëve

Çdo operator që dëshiron të përdorë terminalin duhet të regjistrohet pranë administratës së terminalit. Administrata krijon regjistrin elektronik të operatorëve të autorizuar.

Për regjistrim paraqiten:

- Licenca e transportit;
- Autorizimi për linjën;
- Certifikata e regjistrimit të subjektit;
- NIPT-i;
- Leja e qarkullimit e mjeteve;
- Dokumentacioni i drejtuesve të mjeteve.

Neni 25
Detyrimet e Operatorëve

Operatorët janë të detyruar:

a. Operatorët duhet të kryejnë shërbimin sipas orareve të miratuara nga autoritetet përkatëse, duke garantuar nisjen, mbërritjen dhe qarkullimin e mjeteve në përputhje me grafikun zyrtar të lëvizjes së linjës.

b. Operatorët janë të detyruar të përdorin vetëm platforma dhe hapësirat e përcaktuara nga administrata e terminalit për qëndrimin, hipjen dhe zbritjen e pasagjerëve, pa penguar funksionimin normal të terminalit.

c. Operatorët duhet të sigurojnë paraqitjen e mjeteve në terminal brenda afateve të përcaktuara për regjistrim, kontroll dhe përgatitje të nisjes, duke shmangur vonesat dhe çrregullimet në shërbim.
d. Operatorët mbajnë përgjegjësi për mirëmbajtjen teknike, pastërtinë dhe sigurinë e mjeteve, duke garantuar që ato të përmbushin të gjitha standardet ligjore dhe kushtet për transportin e pasagjerëve.
e. Operatorët janë të detyruar të zbatojnë të gjitha urdhrat, rregullat dhe udhëzimet e dhëna nga administrata e terminalit dhe personeli përgjegjës për administrimin e tij.
f. Operatorët duhet të kryejnë në kohë pagesat për tarifat e përdorimit të terminalit dhe çdo detyrim tjetër financiar të parashikuar nga aktet rregullatore në fuqi.
g. Operatorët dhe personeli i tyre duhet të ofrojnë shërbim profesional, korrekt dhe të respektueshëm ndaj pasagjerëve, duke garantuar trajtim të barabartë dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.
h. Operatorët operojnë me një më stacio fundor qytetit e Sarandës dhe çdo përdorues të territorit të terminalit dhe ata turistikët, kanë detyrimin që përkara hyrjes në terminal të vendosin në dispozicion të strukturës administruese përtej dokumentacionit tjetërt dhe listën me të gjitha mjetet dhe targat përkatese që do të hyjnë në terminal.

Neni 26
Detyrimet e Drejtuesve të Mjeteve

Drejtuesit e mjeteve janë të detyruar:

a. Drejtuesit duhet të zbatojnë të gjitha shenjat rrugore, sinjalistikën e terminalit dhe udhëzimet e personelit përgjegjës për qarkullimin dhe organizimin e trafikut brenda terminalit.
b. Ndalohet kryerja e çdo manovre që mund të rrezikojë sigurinë e pasagjerëve, këmbësorëve, mjeteve të tjera apo infrastrukturës së terminalit.
c. Drejtuesit duhet të sigurojnë lëvizje të rregullt të mjeteve dhe të shmangin ndalimet ose parkimet që pengojnë qarkullimin normal brenda terminalit.
d. Drejtuesit janë të detyruar të zbatojnë menjëherë çdo udhëzim të dhënë nga personeli i autorizuar për parkimin, lëvizjen, sistemimin dhe operimin e mjeteve në terminal.

Neni 27
Veprimet e Ndaluara

Në territorin e terminalit ndalohet:

a. Operatorët dhe drejtuesit nuk mund të kryejnë hipje apo zbritje pasagjerësh në pika të paautorizuara, me qëllim shmangien e përdorimit të terminalit.
b. Çdo mjet duhet të parkohet vetëm në hapësirat e përcaktuara nga administrata, duke respektuar organizimin e trafikut dhe sigurinë e përdoruesve.
c. Ndalohet zënia ose përdorimi i sipërfaqeve publike të terminalit për qëllime private apo tregtare pa miratimin paraprak të administratës.

d. Vendosja e reklamave, afisheve, pankartave apo materialeve promocionale pa lejen përkatëse të administratës së terminalit është e ndaluar.
e. Shitja ose shpërndarja e biletave duhet të kryhet vetëm në sportelet ose pikat e autorizuara për këtë qëllim nga struktura administruese.
f. Asnjë operator apo drejtues mjeti nuk mund të ushtrojë aktivitet brenda terminalit pa disponuar licencat, lejet dhe dokumentacionin e nevojshëm të vlefshëm sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 28
Pezullimi i së Drejtës së Përdorimit

Administrata e terminalit mund të pezullojë përkohësisht ose pjesërisht të drejtën e përdorimit të terminalit për operatorët që:

a. Kur konstatohen shkelje të vazhdueshme të dispozitave të kësaj rregulloreje, administrata ka të drejtë të marrë masa kufizuese deri në pezullimin e aktivitetit.
b. Mosshlyerja e detyrimeve financiare brenda afateve të përcaktuara përbën shkak për pezullimin e përkohshëm të së drejtës së përdorimit të terminalit.
c. Çdo veprim ose mosveprim që rrezikon sigurinë e pasagjerëve, personelit apo infrastrukturës së terminalit përbën bazë për marrjen e masave administrative.
d. Operatorët që dëmtojnë qëllimisht ose nga pakujdesia asetet dhe pajisjet e terminalit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar , janë të detyruar të dëmshpërblejnë dhe mund t'u pezullohet e drejta e përdorimit.
e. Çdo përdorim i hapësirave, pajisjeve ose shërbimeve të terminalit në kundërshtim me destinacionin dhe autorizimet e dhëna nga administrata është i ndaluar dhe sjell masa administrative.
f. Pezullimi vendoset me njoftim me shkrim nga administrata e terminalit, duke përcaktuar arsyet, afatin e pezullimit dhe kushtet që duhet të plotësohen për rikthimin e së drejtës së përdorimit

KREU VII
KONTRATAT E PËRDORIMIT TË TERMINALIT

Neni 29
Marrëdhënia Kontraktore

Përdorimi i terminalit realizohet nëpërmjet kontratës së lidhur ndërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Sarandë dhe operatorit të transportit.

Kontrata përbën bazën juridike të përdorimit të terminalit dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 30
Përmbajtja e Kontratës

Kontrata përmban:
- identifikimin e palëve;

- linjat e autorizuara;
- oraret e miratuara;
- platforma e përdorimit;
- tarifat;
- afatet e pagesës;
- procedurat e kontrollit;
- penalitetet;
- mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Neni 31
Kohëzgjatja e Kontratës

Kontratat lidhen për një afat të caktuar sipas afatit të licensimit dhe rinovohen pas verifikimit të dokumentacionit ligjor dhe performancës së operatorit.

Neni 32
Ndryshimi i Kushteve Kontraktore

Ndryshimet në itinerare, orare, mjete ose kushte të tjera duhet të raportohen në administratën e terminalit dhe të azhornohen në kontratën përkatëse.

Neni 33
Zgjidhja e Kontratës

Kontrata mund të zgjidhet në rastët si më poshtë:

a. me marrëveshje të palëve;
b. me përfundimin e afatit;
c. në rast humbjeje të licencës;
d. në rast shkeljesh të rënda;
e. për mosshlyerje të detyrimeve financiare.

KREU VIII

SHËRBIMI NDAJ PASAGJERËVE

Neni 34
Standardet e Shërbimit

Administrata siguron që terminali të ofrojë kushte të përshtatshme për pasagjerët, në përputhje me standardet e sigurisë, higjienës dhe aksesueshmërisë.

Neni 35
Të Drejtat e Pasagjerëve

Pasagjerët kanë të drejtë:

a. të informohen për oraret;
b. të përdorin ambientet publike;
c. të marrin informacion mbi ndryshimet e itinerareve;
d. të paraqesin ankesa;
e. të përdorin ambientet në mënyrë të sigurt.

Neni 36
Informimi i Pasagjerëve

Administrata siguron afishimin e orareve,itinerareve, tarifave, rregullave të sigurisë, procedurave të emergjencës.

Informacioni publikohet në mënyrë fizike dhe elektronike.

Neni 37
Ankesat dhe Sugjerimet

Administrata krijon sistem për regjistrimin e ankesave, shqyrtimin e tyre, kthimin e përgjigjeve ndaj qytetarëve.

Çdo ankesë trajtohet brenda afateve të përcaktuara nga procedurat e brendshme.

Neni 38
Mbrojtja e Pasagjerëve

Administrata merr masa për parandalimin e incidenteve, monitorimin e ambienteve, ruajtjen e rendit dhe asistimin e pasagjerëve në raste emergjente.

KREU IX

SHKELJET, PENALITETET DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Neni 39
Përgjegjësia për Shkeljet

Çdo operator, drejtues mjeti, subjekt tregtar ose përdorues i terminalit mban përgjegjësi për shkeljet e kësaj rregulloreje dhe për dëmet e shkaktuara ndaj pronës publike ose përdoruesve të tjerë, duke vepruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në përputhje me dispozitat ligjore e rregullatore në fuqi.

Neni 40
Klasifikimi i Shkeljeve

Shkeljet ndahen në:

Shkelje të Lehta

i. vonesa deri në 10 minuta, e cila mund të ndodhë në hyrje, dalje ose gjatë përdorimit të shërbimeve të terminalit;
ii. mosparaqitja në kohë e dokumentacionit të kërkuar nga administrata ose organet e kontrollit;
iii. mosrespektimi i procedurave administrative, si mosplotësimi i formularëve apo mosndjekja e hapave të përcaktuara.

Shkelje të Mesme

i. përdorimi i paautorizuar i platformeëve, hapësirave ose pajisjeve të terminalit, që mund të shkaktojë pengesa në funksionimin normal;
ii. mosrespektimi i orareve të përcaktuara për hyrje, dalje, ngarkim, shkarkim apo qëndrim në terminal.

Shkelje të Rënda

i. përdorimi i terminalit pa dokumentacion të vlefshëm ose me dokumente të falsifikuara, të cilat rrezikojnë sigurinë dhe legalitetin e përdorimit;
ii. paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, me qëllim mashtrimin e administratës ose shmangien e detyrimeve ligjore;
iii. rrezikimi i sigurisë së pasagjerëve, përmes veprimeve të pakujdesshme ose të qëllimshme që mund të shkaktojnë dëme;
iv. dëmtimi i qëllimshëm i infrastrukturës së terminalit, duke përfshirë ndërtesat, pajisjet, sinjalistikën dhe hapësirat e përbashkëta;
v. ushtrimi i aktiviteteve të paligjshme, të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi dhe cenojnë rendin, sigurinë dhe funksionimin e terminalit.

Neni 41
Masat Administrative

Në varësi të natyrës së shkeljes, administrata mund të aplikojë masat e mëposhtme:

a. paralajmërim verbal, për shkelje të lehta që nuk përsëriten dhe nuk shkaktojnë dëme;
b. paralajmërim me shkrim, që shërben si njoftim zyrtar dhe i shërben përmirësimit të sjelljes së operatorit;
c. penalitet financiar maksimalisht deri ne 20.000 leke , në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundravajtjet administrative
d. pezullim të përkohshëm të përdorimit të platformeit, për të garantuar sigurinë dhe mbarëvajtjen e terminalit;

e. *pezullim të përkohshëm të përdorimit të terminalit, kur shkelja ka ndikim të gjerë ose* përsëritet;
f. Ndërprerje të kontratës, në rastet e shkeljeve të rënda, të përsëritura ose kur operatori nuk respekton parimet e bashkëpunimit dhe rregullat e terminalit.

Neni 42
Riparimi i Dëmit

Subjekti që shkakton dëmtim të infrastrukturës së terminalit detyrohet të mbulojë plotësisht kostot e riparimit ose zëvendësimit të saj, përfshirë materiale, punë dhe çdo shpenzim shtesë të lidhur me rikthimin e funksionalitetit të plotë të terminalit.

KREU X

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 43
Aktet e Brendshme

Për zbatimin e kësaj rregulloreje, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë miraton procedurat operative të brendshme, formularët standardë dhe udhëzimet administrative.

Neni 44
Dispozitat Kalimtare

Operatorët ekzistues që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Sarandë dhe operatorët e kthimit detyrohen të regjistrohen dhe të lidhin kontratë me administratën e terminalit brenda afatit të përcaktuar nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë.

Neni 44
Interpretimi

Interpretimi i dispozitave të kësaj rregulloreje bëhet nga administrata e terminalit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 45
Zbatimi

Ngarkohet Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Sarandë me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Bashkiak i Sarandës dhe publikimit sipas legjislacionit në fuqi.

TARIFAT E OPERIMIT TË TERMINALIT TË TRANSPORTIT PUBLIK

Intervali Kohor	Tarifa
Furgon dhe mikrobuzë	
1 Orë	80 Lekë
1-3 Orë	150 Lekë
3-8 Orë	350 Lekë
12-24 Orë	550 Lekë
Autobus deri 32+1 vende	
1 Orë	100 Lekë
1-3 Orë	200 Lekë
3-8 Orë	400 Lekë
12-24 Orë	600 Lekë
Autobus nga 32+1 deri 42+1 vende	
1 Orë	150 Lekë
1-3 Orë	300 Lekë
3-8 Orë	500 Lekë
12-24 Orë	700 Lekë
Autobus mbi 42+1 vende	
1 Orë	200 Lekë
1-3 Orë	400 Lekë
3-8 Orë	600 Lekë
12-24 Orë	800 Lekë

** Detyrimi total i cdo operatori do të llogaritet sipas kohes dhe orareve të përcaktura në licensen përkatese dhe do të jetë pjese e kontratës që do të lidhet me strukturën administruese.*

TARIFAT E PARKIMIT PUBLIK TË TERMINALIT

Intervali Kohor	Tarifa
0-3 Orë	150 Lekë
3-8 Orë	400 Lekë
8-12 Orë	550 Lekë
12-24 Orë	800 Lekë

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

POROSITËSI:Bashkia Sarandë **DATË** 11/03/2026 **QËLLIMI**: REGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA SARANDË DV ASHK SARANDË ZONA KADASTRALE 8642(SARANDË) NUMRI PASURISË _____ INDEKS HARTËS:SR; H-11.


TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISË "Truall" SIP.PASURISË= 8911.89m² SIPERFAQE GJURMËS SË NDËRTIMIT= 7850m² NUMRI KATEVE=3 NUMRI I PEMËVE_____

X=4416373.73
Y=4415660.30

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=4416567.53
Y=4415660.30



X=4416373.73
Y=4415511.08

SH 1:1000

X=4416567.53
Y=4415511.08

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERIU					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERENDIM					

REALIZOI PER BASHKINË SARANDË

PUNOI: AMELA HADO TAULANT HYSENI

NENSHKRIMI

DREJTORI: ZENEL BAJRAMI

NENSHKRIMI

KRYETARI: OLTION ÇAÇI

NËNSHKRIMI

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____

NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE .T,Z,O,S.

Kode për teknologjinë e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI I KUFIRIT :P,HK.

Kode për përcaktimin e kufirit: P-Përfaqësues i Pronarëve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.

SHENIME TE VECANTA: Ky plan rilevimi u përgatit duke u bazuar në Lejen e Ndertimit nr. 6, datë 20.11.2023 "PER LEJE NDERTIMI PER NDERTIM TE RI ME SIPERFAQE ME TE MADHE SE 250M2", Bashkia Sarandë.

KORDINATAT NE SISTEMIN GJEODEZIK GAUSS-KRUGER.

1.X=4416434.48 Y=4415646.88 2.X=4416469.38 Y=4415635.5 3. X=4416459.12 Y=4415595.20 4. X=4416495.17 Y=4415592.76
5.X=4416500.51 Y=4415626.51 6. X=4416543.00 Y=4415616.70 7. X=4416538.75 Y=4415600.53 8. X=4416554.20 Y=4415591.59
9.X=4416555.32 Y=4415578.07 10. X=4416519.92 Y=4415576.48 11. X=4416518.53 Y=4415543.72 12. X=4416422.75 Y=4415547.34
13.X=4416425.13 Y=4415583.61 14. X=4416393.25 Y=4415588.20 15. X=4416395.80 Y=4415607.03 16. X=4416415.70 Y=4415605.18
17.X=4416419.95 Y=4415622.25 18. X=4416426.11 Y=4415621.19

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET